



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR
Drejtoria e Buxhetit Financës dhe Investimeve

Nr. Prot.

Tiranë, më _____ 2015

DREJTUAR: **Ministrisë së Financave**
Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit
Drejtorisë së Analizave dhe Politikave Buxhetore

LENDË: **Mbi raportet e monitorimit për periudhën**
janar - mars 2015

Në mbështetje të ligjit nr.160/2014 "Për Buxhetin e vitit 2015", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2 datë 06.02.2012 "Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr.2 datë 9.01.2015 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2015", po ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për pushtetin gjyqësor, sipas programeve buxhetore të miratuara për periudhën janar - mars 2015.

Programi - "Buxheti Gjyqësor"

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2015-2017. Ky program konsiston në mbështetjen buxhetore të shërbimeve gjyqësore dhe përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, me qëllim sjelljen e tyre në parametrat dhe cilësinë e performancës së ngjashme me vendet e Bashkimit Europian.

Buxheti i alokuar në këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim kryesor arritjen e standarteve bashkohore në shërbimin gjyqësor nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës ndërtimore dhe elektronike të gjykatave, të cilat krijojnë kushte optimale pune dhe sigurie për gjyqtarët dhe stafin mbështetës si dhe zhvillimin e proceseve gjyqësore dhe shërbimet e tjera ndaj publikut me cilësi dhe transparencë.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Formati nr. 7 - Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për periudhën janar - mars 2015.

Me Ligjin nr.160/2014 "Për Buxhetin e vitit 2015", fondet e akorduara për funksionimin e aktivitetit të gjykatave, sipas artikujve, paraqiten në vijim:

1-Shpenzime Personeli

Fondi i akorduar për periudhën janar - mars për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore është 407,536 mijë lekë. Buxheti i rishikuar është 407,536 mijë lekë dhe realizimi paraqitet në masën 350,876 mijë lekë ose 86% e buxhetit të detajuar dhe buxhetit të rishikuar.

Gjatë periudhës janar - mars, gjykatat nuk kanë përdorur të plotë fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, për shkak të mosplotësimit të strukturave organike.

Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2015, nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë kësaj periudhe. Ka patur mungesa në mesatarisht 73 punonjës, prej të cilëve 41 gjyqtarë të pa emëruar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe 32 punonjës administrate. Konkretisht, ka patur mungesa në strukturat organike në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apeleve Vlorë, Gjirokastrë, Durrës, Shkodër, Tiranë, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Dibër, Fier, Gjirokastrë, Kurbin, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Përmet, Pukë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë.

2-Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar për periudhën janar - mars është 80,528 mijë lekë, ndërsa buxheti i rishikuar është 81,115 mijë lekë. Realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 66,335 mijë lekë ose 82% e buxhetit të rishikuar dhe buxhetit të detajuar në fillim të vitit.

- Gjatë periudhës janar - mars kanë filluar dhe janë në proces procedurat për prokurimin e fondeve të planifikuara nga gjykatat për këtë periudhë për: shtypshkrime, kancelari, letër, tonera, karburant, goma etj, duke ndikuar kështu në performancën e shpenzimeve operative për 3/mujorin e parë.
- Gjithashtu disa gjykata kanë realizuar shtesa kontratash për plotësimin e nevojave të fillim vitit në artikujt shtypshkrime, letër, tonera etj, likuidimi i të cilave është kryer në muajin Prill.

3.- Shpenzime në investime

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit për këtë program është 15,220 mijë lekë, ndërsa realizimi 9,792 mijë lekë ose 64% .

Projekti	në mijë/lekë		
	Plan	Fakt	%
1 .Ndertim	10,500	9,496	90%
2 .Pajisje - Mobilje	4,420	296	7%
3 .Projekt	300	0	0%
TOTALI	15,220	9,792	64%

“Ndertim”

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit në projektin “ Ndertim” për periudhën janar-mars është 10,500 mijë lekë, kurse realizimi 9,496 mijë lekë ose 90%. Ky fond u detajua për vazhdimin e zbatimit të punimeve për ndërtimin e godinës së re të Gjykatës së Apelit Shkodër. Ndërtimi i

godinës do të shtrihet në tre vite 2014-2016. Gjykata ka realizuar të plota likujdimet sipas punimeve të kryera për periudhën janar-mars 2015.

"Paisje Mobilje"

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për 3/mujorin e parë, është 4,420 mijë lekë dhe realizimi 296 mijë lekë ose 7% e buxhetit të detajuar për këtë periudhë. Fondi i realizuar ka të bëjë me likujdimet që kanë kryer 3 gjykata për prokurimet më vlerë të vogël, për blerje paisje e mobilje. Pjesa tjetër e gjykatave janë në process.

Për periudhën 3/mujore, situata e investimeve për këtë projekt, sipas grupeve kryesore të pajisjeve, paraqitet si më poshtë:

✚ *"Paisje elektronike"*. Fondi i detajuar për 3/mujorin është 2,540 mijë lekë, ndërsa realizimi 198 mijë lekë ose 8%.

a) Ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është në proces likujdimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet me fondin 120 mijë lekë

b) Kanë filluar procedurat dhe janë duke përgatitur dokumentacionin e prokurimit:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me fondin 240 mijë lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me fondin 250 mijë lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës me fondin 240 mijë lekë.
- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me fondin në masën 120 mijë lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me fondin 720 mijë lekë.

c) Kanë parashikuar të realizohet prokurimi në muajin prill.

- Gjykata e Apelit Korçë me fondin 240 mijë lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me fondin 120 mijë lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me fondin 120 mijë lekë.
- Gjykata Administrativ e Shkallës së Parë Tiranë me fondin 250 mijë lekë.

✚ *Mobilje* . Fondi i detajuar për 3/mujorin është 1,130 mijë lekë.

a) Ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është në proces likujdimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë me fondin në masën 480 mijë lekë.

b) Kanë filluar procedurat dhe janë duke përgatitur dokumentacionin e prokurimit:

- Gjykata e Apelit Gjirokastrë me fondin 100 mijë lekë.
- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me fondin në masën 350 mijë lekë.

c) Ka parashikuar të realizojë prokurimin në muajin prill, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me fondin 100 mijë lekë.

✚ *"Paisje të tjera"* . Fondi i detajuar për 3/mujorin është 390 mijë lekë.

a) Ka filluar procedurat dhe është duke përgatitur dokumentacionin e prokurimit, Gjykata e Apelit Tiranë me fondin 140 mijë lekë.

b) Ka parashikuar të realizojë prokurimin në muajin prill, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me fondin 250 mijë lekë.

✚ “Paisje sigurie”. Fondi u detajua për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat në masën 360 mijë lekë. Gjykata ka filluar procedurat dhe është duke përgatitur dokumentacionin e prokurimit.

"Projekt".

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për këtë zë të investimeve është 300 mijë lekë. Ky buxhet është detajuar për:

- a) Gjykatën e Apelit Vlorë për hartimin e projekt-preventivit për rikonstrukcion e dy sallave të gjykimit, si dhe për hartimin e projekt-preventivit për hidroizolim të taracës dhe katit përdhe të gjykatës. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është proces likuidimi me operatorin ekonomik fitues.
- b) Gjykatën e Lartë për hartimin e projektit të rikonstrukcionit, për rrjetin e brendshëm LAN. Gjykata ka filluar procedurat e prokurimit.

Formati nr. 8 - Raporti i shpenzimeve sipas Programeve

Buxheti i detajuar për periudhën janar- mars 2015, për këtë program është 503,284 mijë lekë dhe realizimi 427,088 mijë lekë ose 74 %.

Në këtë realizim kanë ndikuar disa faktorë:

- Mospërdorimi i plotë i fondit për shpenzime personeli. Gjatë periudhës janar - mars, ka patur mosplotësime të strukturave organike në disa gjykata konkretisht, në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apeleve Vlorë, Gjirokastrë, Durrës, Shkodër, Tiranë, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Dibër, Fier, Gjirokastrë, Kurbin, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Përmet, Pukë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë.

- Moskryerja e likuidimit për të gjitha shpenzimet e kryera nga gjykatat, në shpenzime operative për shkak se gjykatat janë në proces për prokurimin e fondeve të planifikuara për shtypshkrime, kancelari, letër, tonera, karburant, goma etj.

- Edhe për buxhetin në investime, gjykatat janë duke kryer procedurat e prokurimit për fondet e detajuara për këtë periudhë.

Formati nr.9 - Raporti i Realizimit të Produkteve të Programit

Programi “Buxheti Gjyqësor” për periudhën janar - mars 2015 përbëhet nga disa produkte, të cilat janë në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP). Në funksion të objektivit të parë të DPP-se, janë përcaktuar disa produkte, realizimi sasior i të cilëve paraqitet si më poshtë:

Produkti A “Çështje të gjykuara në vit”- Njësia matëse nr.çështjesh.

Numri i çështjeve të parashikuara për periudhën janar - mars 2015 është 41,287. Ky parashikim nga ana e gjykatave është kryer referuar tendencës së numrit të çështjeve për disa vite. Për këtë periudhë janë gjykuar plotësisht 37,014 çështje dhe janë në proces për të u gjykuar 4,273 çështje. Nga një këndvështrim i përgjithshëm, në realizimin sasior të këtij produkti ka ndikuar

mosplotësimi i strukturave organike në disa gjykata. Por, duhet të merret në konsideratë edhe fakti që në realizimin e çështjeve gjyqësore ndikojnë edhe një sërë faktorësh të tjerë proceduriale apo substanciale që paraqiten specifike për çdo çështje.

Produkti B- “Sipërfaqe godine e re” - Njësia matëse m².

Ky produkt për periudhën janar - mars është parashikuar të realizohet në Gjykatën e Apelit Shkodër në masen 233 m² sipërfaqe godine e re, kurse është realizuar 215 m².

Produkti D - “Projekt zbatim për rikonstruksion të plotë të godinave të gjykatave”. Njësia Matëse - nr. institucioni.

- a) Në këtë produkt është detajuar buxhet për Gjykatën e Apelit Vlorë për hartimin e projekt-preventivit për rikonstruksion e dy sallave të gjykimit, si dhe për hartimin e projekt-preventivit për hidroizolimim e taracës dhe katit përdhe të gjykatës. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është proces likuidimi me operatorin ekonomik fitues.
- b) Në Gjykatën e Lartë për hartimin e projektit për rikonstruksionin e rrjetit të brëndshëm LAN. Gjykata ka filluar procedurat e prokurimit.

Produkti F “Mobilje për zyra dhe salla gjyqi për gjykatat ” - Njësia matëse nr. institucioni.

Në këtë produkt për periudhën janar - mars, është parashikuar realizimi i mobiljeve për zyra dhe salla gjyqi, për 5 institucione dhe konkretisht është realizuar:

- Plotësisht në 1 institucion.
- Pjesërisht në 3 institucione: Gjykata e Apelit Gjirokastrë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër kanë filluar procedurat e prokurimit, kanë përgatitur dokumentacionin dhe specifikimet teknike, kurse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë është në proces likuidimi.
- Aspak në 1 gjykatë. Nuk është bërë i mundur prokurimi i fondeve në këtë produkt për këtë periudhë. Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër ka filluar procedurat e prokurimit gjatë muajit prill.

Produkti G -“Elementë sigurie për gjykatat”- Njësia matëse nr. institucioni.

Në këtë produkt është parashikuar realizimi i pajisjeve të sigurisë (kamera sigurie) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, e cila ka filluar procedurat.

Produkti H -“Paisje të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatave”- Njësia matëse nr. Institucioni.

Në këtë produkt për periudhën janar - mars është parashikuar realizimi i disa paisjeve të tjera të domosdoshme për aktivitetin e gjykatës, konkretisht për Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka filluar procedurat në muajin mars si dhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila ka filluar procedurat e prokurimit gjatë muajit prill.

Në funksion të objektivit të dytë të DPP-se, është përcaktuar një produkt, realizimi sasior i të cilit paraqitet si më poshtë:

Produkti J -“Paisje elektronike për gjykatat” -Njësia matëse për këtë produkt “nr.institucioni”.

Në këtë produkt për periudhën janar - mars është parashikuar realizimi i pajisjeve elektronike për 12 institucione dhe realizimi paraqitet:

- Plotësisht në 2 institucione.
- Pjesërisht në 6 institucione.
- Aspak në 4 institucione. Nuk u bë i mundur prokurimi i fondeve në këtë produkt për periudhën janar-mars. Gjykatat kanë filluar procedurat e prokurimit në muajin prill.

Në funksion të objektivit të tretë të DPP-se, është përcaktuar një produkt, realizimi sasior paraqitet si më poshtë:

Produkti K -“Gjyqtare të trajnuar për anën profesionale të tyre” - Njësia matëse nr.gjytaresh.

Në këtë produkt për periudhën 3/mujore është parashikuar mbështetja me buxhet për shpenzimet “udhetim e dieta”për trajnimin profesional të 47 gjyqtarëve nga Shkolla e Magjistratures, ndërkohe që janë realizuar trajnimë për 43 gjyqtarë. Për këtë produkt shpjegojmë se trajnimet janë kryer nga Shkolla e Magjistratures, në bazë të detyrimit ligjor që ka ky institucion.

Formati nr.10- Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Produkteve

Programi 03310 “Buxheti Gjyqësor” për periudhën janar-mars 2015 përbëhet nga disa produkte të cilat janë në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP). Në funksion të objektivit të parë të DPP-se, janë përcaktuar disa produkte, realizimi vleror i të cileve paraqitet si më poshtë:

Produkti A - “Çështje të gjykuara në vit”. Buxheti për këtë produkt për periudhën janar - mars 2015, është planifikuar në shumën 487,294 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 416,574 mijë lekë ose 86%. Në këtë realizim kanë ndikuar disa faktorë:

- Mospërdorimi i plotë i fondit për shpenzime personeli. Gjatë periudhës janar - mars, ka patur mosplotësim të strukturave organike në disa gjykata si në: Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apeleve Vlorë, Gjirokastrë, Durrës, Shkodër, Tiranë, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Dibër, Fier, Gjirokastrë, Kurbin, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Përmet, Pukë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë.
- Gjatë periudhës janar-mars kanë filluar dhe janë në proces procedurat për prokurimin e fondeve të planifikuara nga gjykatat për shtypshkrime, kancelari, letër, tonera, karburant, goma etj, duke ndikuar kështu si për produktin, por edhe në performancën e shpenzimeve operative për këtë periudhë.

Produkti B- “Sipërfaqe godine e re”. Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit në këtë produkt për periudhën janar-mars është 10,500 mijë lekë, kurse realizimi 9,496 mijë lekë ose 90%. Ky fond u detajua për vazhdimin e zbatimit të punimeve për ndërtimin e godinës së re të Gjykatës së Apelit Shkodër. Ndërtimi i godinës do të shtrihet në tre vite 2014-2016. Gjykata ka realizuar të plota likujdimet sipas punimeve të kryera për periudhën janar-mars 2015.

Produkti D - “Projekt zbatim për rikonstrukcion të plotë të godinave të gjykatave”. Në këtë produkt për periudhën janar- mars është parashikuar një buxhet në vlerën 300 mijë lekë

përkatësisht: Për Gjykatën e Apelit Vlorë në vlerën 200 mijë lekë, për hartimin e projekt-preventivit për rikonstruksion e dy sallave të gjykimit, si dhe për hartimin e projekt-preventivit për hidroizolimimin e taracës dhe katit përdhe të gjykates. Gjykata ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është proces likuidimi me operatorin ekonomik fitues. Për Gjykatën e Lartë është detajur fondi në masën 100 mijë lekë, për hartimin e projektit për rikonstruksionin e rrjetit të brendshëm LAN. Gjykata ka filluar procedurat e prokurimit.

Produkti F- “Mobilje për zyra dhe salla gjyqi për gjykatat ”. Buxheti për këtë produkt është 1,130 mijë lekë, kurse realizimi është 98 mijë lekë.

- a) Ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është në proces likuidimi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë me fondin në masën 480 mijë lekë.
- b) Kanë filluar procedurat dhe janë duke përgatitur dokumentacionin e prokurimit:
 - Gjykata e Apelit Gjirokastrë me fondin 100 mijë lekë.
 - Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me fondin në masën 350 mijë lekë.
- c) Është parashikuar të realizohet prokurimi në muajin prill për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me fondin 100 mijë lekë.

Produkti G -“Elementë sigurie për gjykatat”. Në këtë produkt për periudhën janar - mars është parashikuar një buxhet në vlerën 360 mijë lekë për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat “kamera sigurie”. Gjykata është në proces të realizimit të kësaj procedure.

Produkti H -“Pajisje të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatave”. Për këtë produkt është parashikuar buxhet për periudhën janar - mars në vlerën 390 mijë lekë.

- a) Ka filluar procedurat dhe është duke përgatitur dokumentacionin e prokurimit, Gjykata e Apelit Tiranë me fondin 140 mijë lekë.
- b) Ka parashikuar të realizojë prokurimi në muajin prill, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me fondin 250 mijë lekë.

Në funksion të objektivit të dytë të DPP-se, është përcaktuar një produkt, realizimi vleror i të cilit paraqitet si më poshtë:

Produkti J -“Pajisje elektronike për gjykatat”. Buxheti për periudhën 3/mujore për këtë produkt është 2,540 mijë lekë, ndërsa është realizuar 198 mijë lekë. Për realizimin e produktit shpjegojme:

- a) Ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është në proces likuidimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet me fondin 120 mijë lekë
- b) Kanë filluar procedurat dhe janë duke përgatitur dokumentacionin e prokurimit:
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me fondin 240 mijë lekë.
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me fondin 250 mijë lekë.
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës me fondin 240 mijë lekë.
 - Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me fondin në masën 120 mijë lekë.

-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me fondin 720 mijë lekë.

c) Kanë parashikuar të realizohet prokurimi në muajin Prill .

- Gjykata e Apelit Korçë me fondin 240 mijë lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me fondin 120 mijë lekë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me fondin 120 mijë lekë.
- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me fondin 250 mijë lekë.

Në funksion të objektivit të tretë të DPP-se, është përcaktuar një produkt, ku për periudhën janar-mars, realizimi vleror i saj paraqitet si më poshtë:

Produkti K- “Gjyqtarë të trajnuar për anën profesionale të tyre”. Ky produkt për periudhën janar-mars është parashikuar në masën 770 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën prej 721 mijë lekë, ose 94%.

Programi- “Planifikim menaxhim dhe administrim ”

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP). Ky buxhet është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP; harmonizimi i nevojave të gjykatave me burimet financiare në dispozicion për pushtetin gjyqësor, në funksion të mbështetjes së shërbimeve gjyqësore, përmirësimit tërësor të infrastrukturës së gjykatave për realizimin e proceseve gjyqësore dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj publikut. Kjo politikë ka si qëllim kryesor, menaxhimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore, që miratohen për Pushtetin Gjyqësor për të siguruar pavaresinë financiare të Gjyqësorit .

Formati nr. 7 - Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për periudhën janar - mars 2015.

Me Ligjin Nr. nr.160/2014, "Për Buxhetin e vitit 2015", Zyrës të Administrimit të Buxhetit Gjyqësor i janë akorduar fondet, sipas artikujve si më poshtë:

1.Shpenzime Personeli

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit si dhe buxheti i rishikuar për periudhën janar - mars, për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore është 5,380 mijë lekë kurse realizimi është 4,987 mijë lekë ose 93% e buxhetit të detajuar dhe të rishikuar.

2.Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit si dhe buxheti i rishikuar për periudhën janar - mars për vitin 2015 është 1,100 mijë lekë. Realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 620 mijë lekë, ose 56 % ndaj buxhetit të planifikuar, si dhe buxhetit të rishikuar. Në realizimin e zërit “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” ka ndikuar moslikujtimi i plotë gjatë kësaj periudhe i shpenzimeve të internetit dhe energjise elektrike për shkak të mosparaqitjes së faturës. Gjithashtu është në proces kryerja e likuidimeve për udhëtim-dieta dhe mirëmbajtje godine.

3.Investime

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën janar -mars është 300 mijë lekë. Ky program përbëhet nga një projekt “Paisje mobilje”. Fond u detajua për plotësimin e nevojave për mobilje

dhe paisje të tjera, për punonjësit e ZABGJ-së. Janë në proces procedurat për prokurimin e fondit.

Formati nr.8 - Raporti i shpenzimeve sipas Programeve

Fondi i detajuar për këtë program për periudhën janar-mars 2015, është 6,780 mijë lekë dhe realizimi 5,607 mijë lekë ose 83%. Ky program përbëhet nga dy produkte:

Produkti A- “Buxhet vjetor për Pushtetin Gjyqësor i administruar në mënyre efçente dhe efektive”.

Buxheti për këtë produkt për periudhën janar - mars 2015, është planifikuar në shumën 6,480 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 5,608 mijë lekë ose 87%. Në funksion të realizimit të këtij produkti shërben i gjithë buxheti i detajuar për Zyrën e Adminstrimit të Buxhetit Gjyqësor për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative. Realizimi në këtë përqindje është rrjedhojë e mospërdorimit të plotë të fondit për shpenzime “Mallra e Sherbime” për arsyet e sipërpërmendura.

Produkti C- “Mobilje për zyra për ZABGJ”

Në këtë produkt periudhën janar- mars është parashikuar një buxhet në vlerën 300 mijë lekë, për Zyrën e Adminstrimit të Buxhetit Gjyqësor për plotësimin e nevojave për pajisje mobilje dhe paisje të tjera. Janë në proces procedurat për prokurimin e këtij fondi.